



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 14.01.2013
Nr. 0201-12

Për: Blerim Kuqi, Kryetar i Komunës Suharekë

Lënda: Përgjigje në Kërkesë-Konsultim Paraprak

I nderuar z. Kuqi

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, me datë 04.01.2013, ka pranuar kërkesën për konsultim paraprak lidhur me zhvillimin e procedurave për ndërrimin e emrit të tanishëm të Komunës së Suharekës të përcaktuar me nenin 5 paragrafi 2 pika (22) të Ligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave në emërtim të ri Komuna - *Therandë*.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, bazuar në mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores 02/2011, Për Fushat e Përgjegjësit Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të hollësishëm të kërkesës për konsultim paraprak, ka *konstatuar se*;

- Bazuar në nenin 17, pika (o), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, komunat kanë të drejt të bëjnë emërtimin rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike, por jo edhe ndërrimin e emrit të fshatrave apo Komunës. Emërtimi i ri fshatrave dhe komunave mund të bëhet me ligj të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
- Derisa nuk kemi një ligj për emërtimin e fshatrave dhe komunave të tillë emrat e komunave duhet të përdoren ashtu siç është rregulluar me Ligjin nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativ të Komunave.


MAPL, në bashkëpunim me institucionet tjera ka hartuar koncept-dokumentin për ndryshimin e emrave të fshatrave dhe komunave duke përcaktuar edhe kriteret. Dokumenti në fjalë i paraprin nxjerrjes së ligjit, posa i njëjti të miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës ne mund të procedojmë tutje.

MAPL, është e përkushtuar të ofrojë përkrahje dhe ndihmën e nevojshme komunave, për zbatimin e plotë të këtyre obligimeve që dalin nga legjislacioni i zbatueshëm për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës.


Me respekt,

Slobodan Petrović

Zëvendëskryeministër & Ministër i MAPL



Kopje: *Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL,
Drejtorëve të Departamenteve dhe Zyrave
Arkivit të MAPL-së.*



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana: 14.01.2013
br. 0201-12

Za: Blerim Kuqi, Gradonačelnik Opštine Suva Reka

Predmet: Odgovor na Zahtev-Prethodna Konsultacija

Poštovani g. Kuqi

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, je dana 04.01.2013, primilo zahtev za prethodnu konsultaciju u vezi sa izradom procedura za izmenu sadanjeg imena Opštine Suva Reka odredjeno sa clanom 5 paragraf 2 tačka (22) Zakona o Administrativnim granicama Opština za novo imenovanje u Opština - *Therandë*.

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, na osnovu svog mandata odredjenog sa Zakonom za lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe 02/2011, o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle detaljnog razmatranja zahteva za prethodnu konsultaciju je *konstatovalo* ;

- Na osnovu člana 17, tačka (o), Zakona o Lokalnoj samoupravi br. 03/L-040, opštine imaju pravo da imenuju ulice, uličice i druga javna mesta, ali ne i promenu imena sela ili Opština . Novo imenovanje sela i opština se može vršiti sa usvojenim zakonom od Skupštine Republike Kosovo.
- Dok ne budemo imali jedan zakon za imenovanje sela i opština postojeća imena treba da se koriste onako kako je regulisano po Zakonu br. 03/L-041 o Administrativnim granicama Opština .

MALS, u saradnji sa drugim institucijama je izradilo koncept-dokumenat za izmenu imena sela i opština odredjujući i kriterijume. Navedeni Dokumentat prethodi donošanju zakona, čim se isti usvoji od Vlade Republike Kosovo mi možemo da ga prosledimi dalje .

MALS, je opredljeno da ponudi podršku i potrebnu pomoć opštinama ,za potpuno spovodjenje ovih obaveza koje proizilaze od sprovodljivog zakonodavstva za lokalnu samoupravu u Republiku Kosovo.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović

Zamenik premijera & Ministar MALS



Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar u MALS-a,
Direktorima uprava i kancelarija
Arhivi MALS-a



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA E SUHAREKËS
 OPSTINE SUVA REKA
 THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
DËRGUAR - DOSTAVLJENO - SENT			
Nr. Br. No.	Data Datum Date	Sella Sedište Hq	Adresa Adresa Adress
01-15	03.01.2013	SUHAREKË	PRISHTINE

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration			
Data Datum Date	04.01.2013		
Njesia organizative/	Nr. i Lëndës	Shtojca	Vlera
- III -	0201-12		

PËR/ZA/TO:	z. Slobodan Petroviç-Zëvendës Kryeministre dhe Ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushteti Lokal në Prishtinë.
CC:	z. Besnik Osmani-Sekretar i Përhershëm në MAPL-në
PËRMES/PREKO/THROUGH	
NGA/OD/FROM:	Blerim Kuçi-Kryetar i Komunës në Suharekë
LËNDA/SUBJERAT/SUBJECT:	Kërkesë për konsultim paraprak
DATË/A:	03 janar 2013



Te nderuar,

Me anë të kësaj shkrese Komuna e Suharekës do të fillon procedurat e ndërrimit të emrit të Komunës, nga **Komuna e Suharekës**, si që e ka aktualisht në **Komuna e Therandës**.

Andaj kërkojmë nga Ju që konform nenit 83, të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale që të na këshilloni apo rekomandoni për procedurat të më tutjeshme ligjore për ta bërë një veprim të tillë

Shpresojmë së kërkesa jonë do të hasë në mirëkuptim!

Me respekt

Kopje;
 MAPL-së
 Arkiva